AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

KOMUNIKATË PËR MEDIA

Statistikat e Mirëqenies Sociale, Tetor 2023

24.11.2023
Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) publikon Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin tetor 2023.

Rritet skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në tetor 2023, krahasuar me tetor 2022

Në muajin tetor 2023, nga skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara kanë përfituar 3 333 familje, ku krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak që ishte 2 748 familje, vërehet një rritje prej 21,4%.

Numri i përfituesve nga skemat pensionale dhe skemat e tjera të mirëqenies sociale

Përfituesit e pensioneve dhe skemave tjera sociale	Muaji/Viti		10.2023 / 10.2022
	10.2022	10.2023	
Skema e ndihmës sociale	23 661	20 486	-13,4%
Pensionet bazike të moshës	143 144	150 043	4,8%
Pensionet kontributpaguese të moshës	48 320	48 640	0,7%
Pensionet e personave me aftësi të kufizuara	18 924	20 110	6,3%
Pensionet e Trepçës	1 773	1 450	-18,2%
Pensionet e Forcave të Sigurisë së Kosovës	687	758	10,3%
Pensionet e Trupave Mbrojtëse të Kosovës	1 271	1 309	3,0%
Skema e të verbërve	1 847	1 834	-0,7%
Pensionet Familjare	3 300	2 964	-10,2%
Pensionet e Invalidëve të punës	60	49	-18,3%
Pensionet Paraplegjike dhe Tetraplegjike	2 575	2 911	13,0%
Skema e kompensimit për punëtorët e arsimit për vitet 90/91 deri në 98/99	12 825	13 505	5,3%
Pensionet e familjeve të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës	13 036	12 830	-1,6%
Veteranët	36 766	36 800	0,1%
Skema për përkrahje financiare familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara	2 748	3 333	21,3%

Rënie e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin tetor 2023, krahasuar me muajin tetor 2022, kishte rënie të numrit të përfituesve nga: skema për pensionet invalidore (-18,3%); skema për pensionet e Trepçës (-18,2%); skema e ndihmës sociale (-13,4%) skema për pensionet familjare (-10,2%); skema për familjet e dëshmorëve dhe invalidët e luftës (-1,6%); skema e kompensimeve për personat e verbër (-0,7%).

AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS
AGENCIJA ZA STATISTIKE KOSOVA
KOSOVO AGENCY OF STATISTICS

Rritje e përfituesve nga skemat e pensioneve, krahasuar me një vit më parë

Në muajin tetor 2023, krahasuar me muajin tetor 2022 kishte rritje të numrit të përfituesve nga: skema për mbështetje materiale familjeve që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara (21,3%); skema për pensionet e personave paraplegjik dhe tetraplegjik (13,0%); skema e pensioneve për Forcën e Sigurisë së Kosovës (FSK) (10,3%); skema e pensioneve për personat me aftësi të kufizuara (6,3%); skema e kompensimit për punëtorët e arsimit që punuan gjatë vitit shkollor 1990/91 deri në vitin shkollor 1998/99 (5,3%); skema e pensioneve bazike të moshës (4,8%); skema e pensioneve të Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK) (3,0%); skema e pensioneve kontribut-paguese të moshës (0,7%); skema për veteranët e luftës (0,1%).

Për më shumë informata lidhur me Statistikat e Mirëqenies Sociale për muajin tetor 2023, vizitoni: https://ask.rks-gov.net/Themes/SocialWelfare